

REPUBLIKA E KOSOVË  
 DHE  
 KOMUNITETI I SERBIËS  
 NË EMËR TË POPULLIT

24-08-2017

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I**

**PËRGJITHSHËM PENAL**, me gjyqtarin individual Ilir Bytyqi si dhe zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1464-1/15 të dt. 22.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, përfaqësuesit ligjor i të miturit [REDAKTUAR], prindi [REDAKTUAR] si dhe të pandehurit [REDAKTUAR], me datë 12.07.2017 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me dt. 20.07.2017 përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:** [REDAKTUAR] i lindur me dt. 15.12.1980, nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] me vendbanim në Fshatin [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], (me numër personal [REDAKTUAR]), i martuar, prind i dy fëmijëve, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Se me datë 14.08.2015, rreth orës 20:00, në fshatin Dubravë K. Ferizajt, duke drejtuar automjetin e markës "VW Passat", ngjyrë e gjelbër, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në rrugë, ashtu që derisa këmbësori –fëmija Arben Gashi ishte duke trupuar me vrap rrugën e godet me pjesën e përparme të automjetit, nga kjo goditje i dëmtuari [REDAKTUAR] bije në asfalt, me ç'rast ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë: gërvishtje në regjionin e trupit, me pasoja të përkohshme për shëndetin të përshkruar në ekspertizën mjeko – ligjore të datës 22.06.2016.

me të cilën kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 4,5,8,11,41,43,45,49,50,51,73,74, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e

### GJYKON

- *DËNIM ME BURG ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) Muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 1/një/ Viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.*
- *I dëmtuari [REDAKTUAR] me përfaqësuesi ligjor prindin [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.*
- *Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumën prej 60.88€/gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent), në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.*

### Arsyetimi

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1464-1/15 e dt.22.08.2016, ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 12.07.2017, në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuzën, me vjen keq për këtë veprë penale, ndihem thellë i penduar, është hera e parë që ndeshem me ligjin, kërkoj falje publike të dëmtuarit, njoftoj gjykatën se kam shkuar të shtëpia e tij dhe e kam marrë për ta dërguar në Emergjencë për të ofruar ndihmë mjekësore, për këtë jam ndier i penduar pasi që ka ndodhur nga pakujdesia dhe papritmas, i propozoj gjykatës që gjatë matjes së dënimit të më shqipton një dënim sa më të butë.*

Përfaqësuesi ligjor i të miturit [REDAKTUAR], prindi [REDAKTUAR] deklaron se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, kërkesën pasurore – juridike do të paraqes në procedurë civile, me te pandehurin kemi raporte të mira, i njëjti është përkujdesur për shëndetin e djalit tim në mundësit e veta.

Prokurori i Shtetit Valdet Avdiu, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar si dhe në procedurën hetimore si dhe: ekspertiza e komunikacionit të datës 07.07.2016, ekspertiza e mjekut ligjor i datës 22.06.2016, raporti mjekësor i Qendres Emergjente – Ferizaj i datës 14.08.2015, raporti i aksidentit 2015CF-1635 i datës 14.08.2015, deklarata e te pandehurit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] 14.04.2015, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.
- Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj Gjyqtari Individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: se me datë dhe kohe të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri duke drejtuar automjetin e markës "VW Passat", ngjyrë e gjelbër, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në rrugë, ashtu që derisa këmbësori –fëmija [REDAKTUAR] ishte duke trupuar me vrap rrugën e godet me pjesën e përparme të automjetit, nga kjo goditje i dëmtuari [REDAKTUAR] bije në asfalt, me ç'rast ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë gërvishtje në regjionin e trupit, me pasoja të përkohshme për shëndetin të përshkruar në ekspertizën mjeko – ligjore të datës 22.06.2016.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të pandehurin [REDAKTUAR] të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, dhe atë veprimet e kundërligjshme të kryera nga i pandehuri me çka rezultojnë nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprës penale.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit

dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë, rrethanë lehtësuese kujdesin ndaj të dëmtuarit, pendimin e thellë dhe real, nuk ka dëshmi se i njëjti është gjykuar me vendim të formës se prerë, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese Gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënimin me kusht si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

I dëmtuari [REDAKTUAR], përfaqësuesi i tij ligjor prindi [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 450-450 të KPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumën prej 60.88€/gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent), në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**Divizioni penal, P.nr.789/16, me dt.20.07.2017**

**Zyrtare ligjore**  
**Kadishe Shabani**

**Gjyqtari: Ilir BYTYQI**

*F. Bytyqi*

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet Gjykatës Themelore Ferizaj.